



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 197 / 3 prot.

Elbasan, më 31.01.2024

VENDIM
Nr. 4 datë 31.01.2024

**“Për
miratimin e studentëve përfitues të mbështetjes financiare të studentëve në programet e
studimit që përbëjnë prioritet kombëtar në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër
Xhuvani”, që financohen nga UE**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 ”Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar; VKM-s nr. 386, datë 01.06.2022 “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, udhëzimit të MAS nr. 30, datë 04.11.2022 për këtë qëllim, shkresës së AKFAL nr.230/4 prot, datë 22.12.2023 (në UE shkresa nr. 3144 prot, datë 26.12.2023 “Përcillet lista dhe dokumentacioni i studentëve, të cilët kanë aplikuar për përfitimin e mbështetjes financiare, në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar, për vitin akademik 2023-2024, si dhe kërkohet të dërgohen vendimet e Senatit Akademik për shpërndarjen e kuotave dhe përzgjedhjen e studentëve përfitues”, shkresës së AKFAL nr.233/6 prot, datë 22.12.2023 (në UE shkresa nr. 3143 prot, datë 26.12.2023 “Njoftim për kuotat e miratuara për mbështetjen financiare, në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar, për vitin akademik 2023-2024”, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e studentëve që përfitojnë “Mbështetjen financiare të studentëve në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar” në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për 25 studentë me financim nga fondet e kërkimit shkencor për mbështetje studentore nga të ardhurat e Universitetit, si më poshtë:
2. Ky vendim i përcillet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë - AKFAL për procedura të mëtejshme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Skender Topi

